



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY



REPUBLICA E KOSOVES-REPUBLIC OF KOSOVO  
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Nr. Prot. 03-03/1097/20  
B. Prot. 03  
Pr. Prot. 03-03/1097/20  
Pr. Prot. 03-03/1097/20

Nr. i fjal. 03  
Broj stranica 03  
Nr. pages 03

Data 03.06.2020  
Datum 03.06.2020  
Date 03.06.2020

PRISHTINE

DATË/A:	02/06/2020
REFERENC-Ë:	AKK- DPKPP /03-03-1063/2020
PËR/ZA/TO:	Arlinda HASANI, Udhëheqëse e Zyrës së Prokurimit në Universitetin Kadri Zeka
CC:	Vaxhid SADRIU, Sekretar në Universitetin Kadri Zeka
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Shaip HAVOLLI, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
NGA/OD/FROM:	Afrim ATASHI, Drejtor i Departamentit për Parandalimin e Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin " <b>Renovimi i sallave mësimore të UKZ-së</b> "



*E nderuara znj. Hasani,*

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 9 (par. 1, nënpar. 1.5.), 16 (par. 2) dhe 21 (par. 3) të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, nenit 2 par.3 dhe të nenit 10 të Rregullores nr. 01/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 01/2014 dhe Rregullores nr. 01/2017, së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me tenderin me titull: " **Renovimi i sallave mësimore të UKZ-së**", me numër të prokurimit: 941-20-2061-5-2-1, dhe me nr. të brendshëm: UKZ 208-97700/20/009/521, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

## OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin me titull: " **Renovimi i sallave mësimore të UKZ-së**", me numër të prokurimit: 941-20-2061-5-2-1, dhe me nr. të brendshëm: UKZ 208-97700/20/009/521, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për prokurimin

publik nr.04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.04/L -237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092.

### *Arsyetimi*

Agjencia kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtejshëm Agjencia), duke vepruar sipas detyrës zyrtare pas kontrollimit të njoftimeve për kontratë që ka bërë në Sistemin elektronik të Prokurimit, me datë 02/06/2019, ka nxjerrë vendim me numër protokoll: *DPK 03-03/1063/20*, për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit publik me titull: "**Renovimi i sallave mësimore të UKZ-së**", me numër të prokurimit: 941-20-2061-5-2-1, dhe me nr. të brendshëm: UKZ 208-97700/20/009/521, i iniciuar nga Autoriteti kontraktues Universiteti Publik Kadri Zeka.

Agjencia në bazë të dokumenteve të nxjerra nga platforma **E-Prokurimi**, ka analizuar Njoftimin për kontratë dhe Dosjen e Tenderit, ku në nenin IV.3.4), të njoftimit për kontratë është specifikuar, *Vlera e sigurisë së tenderit 580.00 euro*.

Bazuar në legjislacioni në fuqi konkretisht nenin 57- Sigurimi i tenderit, të Ligjit për Prokurim Publik Nr.04/L-042 , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, *Agjencia kundër Korrupsionit konstaton se një autoritet kontraktues ka të drejtë që në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë të kërkoj sigurimin e tenderit, mirëpo nëse autoriteti kontraktues vendos një kërkesë të tillë atëherë siguria e tenderit nuk mund të jetë më pak se një mijë (1.000) Euro.*

Andaj, Agjencia kundër Korrupsionit konsideron se kërkesa e specifikuar në nenin IV.3.4 në njoftimin për kontratë, është në kundërshtim me nenin 57 paragrafi 3 të Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, si dhe me nenin 29 paragrafi 4 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimi Publik, ku thuhet: "*Nëse autoriteti kontraktues vendos që të detyrojë depozitimin e sigurisë së tenderit, shuma e sigurisë së tillë duhet të jetë jo më pak se një për qind (1%) dhe jo më shumë se tre për qind (3%) e vlerës së parashikuar të kontratës publike ose konkursit të projektimit, por sidoqoftë, në asnjë rast nuk duhet të jetë më pak se një mijë (1.000) Euro*".

Veprimet e Autoritetit Kontraktues, konsiderojmë se bien ndesh me nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi nenin 27 Dosja e tenderit, **57 paragrafi 3** Sigurimi i Tenderit, të Ligjit për Prokurim Publik Nr.04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, dhe nenin **29 paragrafi 4** të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në aktivitete të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit rekomandon që të evitohen këto shkelje, përmes njoftimit standard për informata shtesë dhe për përmirësimin e gabimeve, duke i njoftuar Operatorët të cilët e kanë tërhequr dosjen e këtij tenderi.

Po ashtu ju njoftojmë se lidhur me këto të gjetura do të njoftohet Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – KRPP.

Autoritetet kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

*Me respekt !*

